



Tekst zyrtar siç është ndryshuar dhe plotësuar me datë 25.06.2009

*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,*

Në bazë të nenit 99.1 100 dhe nenit 64.2 pika (a) dhe (b) të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe Neni 25 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nxjerr:

**RREGULLËN ZGJEDHORE Nr. 04/2008**  
**VOTIMI I PERSONAVE ME NEVOJA DHE RRETHANA TË VEÇANTA**

Neni 1

Përkufizimet dhe Dispozitat e Përgjithshme

1.1 Votimi i Personave me Nevoja dhe Rrethana të Veçanta (VPNRV) sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, do të thotë marrëveshjet e bëra dhe procedurat e ndjekura për ata votues me të drejtë vote në Kosovë të cilët nuk mund të votojnë personalisht në Vendvotim (VV) në të cilën janë caktuar në Ditën e Zgjedhjeve.

1.2 Votuesit e paraparë në këtë kategori janë siç vijojnë:

(a) votuesit e ngjuar në shtëpi: votuesit me zotësi juridike të cilët nuk mund të dalin nga shtëpitë e tyre për të votuar personalisht në Vendvotimin e zakonshëm për shkak të paaftësisë fizike, shëndetësore ose çfarëdo paaftësie tjetër;

(b) votuesit me lëvizje të kufizuar në ndonjë institucion: votuesit me zotësi juridike në hospitalizim, njerëzit e moshuar në shtëpitë e caktuara veçanërisht për të moshuarit, personat me aftësi të zvogëluar mentale në institucionet e kujdesit shëndetësor, të burgosurit në burgje dhe të paraburgosurit në qendrat e paraburgimit; ose

(c) votuesit në rrethana të veçanta: votuesit me zotësi juridike që jetojnë në bashkësitë, të cilët për shkak të zhvendosjes nga vendi afër Vendvotimit të tyre të rregullt ose për shkaqe sigurie, nuk mund të votojnë në Vendvotimin e tyre të caktuar. Për këtë lloj votimi kërkohet miratimi nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ).

1.3 Votimi i personave me nevoja dhe rrethana të veçanta do të zbatohet në Ditën e Zgjedhjeve nga Komisioni i Vendvotimit dhe Ekipe të Lëvizëse (KVVEL), të organizuara nga KKZ-të në komunat e tyre.

1.4 Çdo ekip i Votimit të personave me nevoja dhe rrethana të veçanta do të ketë një libër të votimit në të cilin do të shënohen të dhënat e rëndësishme përkitazi me zhvillimin e VPNRV-së.

1.5 Ekipe të Votimit të personave me nevoja dhe rrethana të veçanta do të punojnë prej orës 09.00 deri 21.00 gjatë Ditës së Zgjedhjeve, duke u nisur nga KKZ-ja dhe duke u kthyer në KKZ.

1.6 Të gjithë anëtarët e ekipit të KVVEL të do të votojnë në VV-në e tyre të rregullt para orës 09.00 në Ditën e Zgjedhjeve.

1.7 Gjykata kompetente duhet të dorëzoj të dhënat te KQZ-ja për personat të cilëve u është marrë zotësia e veprimit me vendim gjyqësor të formës së prerë. Këto të dhëna dorëzohen ashtu siç kërkohet nga KQZ-ja.

## Neni 2

### Votimi i Personave të Ngujuar në Shtëpi

2.1 Votuesi me zotësi juridike i cili dëshiron të regjistrohet si votues i ngjuar në shtëpi , duhet të dorëzojë në KKZ-në përkatëse pesëmbëdhjetë (15) ditë para Ditës së Zgjedhjeve këto dokumente:

a) aplikacionin e plotësuar, një kopje e të cilit është bashkangjitur si Shtojcë I ose kërkesën e shkruar me dorë që përmban të dhënat personale;

b) një fotokopje të certifikatës së paafësisë ose të diagnozës mjekësore në mbështetje të aplikimit të tij/saj.

2.2 Organizatat joqeveritare (OJQ-të) të cilat janë të regjistruara dhe të specializuara për ndihmën e personave të ngjuar në shtëpi mund t'i paraqesin në Sekretariatit e KQZ-së emrat e personave për t'u përfshirë në programin e votuesve të personave të ngjuar në shtëpi.

2.3 KKZ-ja do të shqyrtojë të gjitha aplikacionet duke i krahasuar me kriteret e përcaktuara në nenin 2.1 të kësaj Rregulle dhe do t'i informojë me shkrim të gjithë aplikantët nëse u janë pranuar ose refuzuar aplikacionet e tyre.

2.4 KKZ-ja duhet t'i informojë ata aplikantë të cilëve u janë refuzuar kërkesat se ata, ose mund të votojnë personalisht në Vendvotimin e caktuar, mund të kërkojnë korrigjim ligjor në pajtueshmëri me nenin 6 të kësaj rregulle.

2.5 Pas afatit përfundimtar për paraqitjen e aplikacioneve për të qenë votues i ngjuar në shtëpi, KKZ-ja do të:

a) përpiloj listën e të gjithë votuesve të ngjuar në shtëpi të regjistruar të asaj komune ,duke përfshirë emrin dhe mbiemrin e tyre, numrin personal të letërnjoftimit dhe adresën e shtëpisë të secilit votues të ngjuar në shtëpi;

b) dorëzoj një kopje të votuesve të ngjuar në shtëpi të regjistruar, në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).

c) bëj ndarjen e listës sipas adresave në atë mënyrë që njerëzit nga një zonë e njëjtë gjeografike të vizitohen nga i njëjti Komisionin i Vend Votimit Ekip Lëvizës (KVVEL); dhe

d) bëj të gjitha përgatitjet adekuate, përfshirë transportimin e KVVEL-së ose kompensimin e shpenzimeve të transportit.

2.6 KVVEL-ja do të përbëhet nga një Kryesues dhe dy anëtarë. KKZ-ja do të vendosë numrin e KVVEL-ve të nevojshëm për të udhëhequr procesin e Votimit të personave të Ngujuar në Shtëpi dhe do t'i plotësojë këto poste nga radhët e anëtarëve rezervë të këshillave të vendvotimeve (KVV-ve), siç është vendosur në nenin 79 të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Jo më shumë se një person nga një subjekt politik mund të emërohet anëtar i KVVEL-së. Me rastin e zëvendësimit të një anëtarit të KVVEL-së, do të zbatohen procedurat e caktuara në nenin 74.7 të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

2.7 KKZ-ja do t'i informojë paraprakisht vëzhguesit e akredituar për drejtimet nga do të shkojnë KVVEL-të për t'u mundësuar vëzhguesve që t'i shoqërojnë ata në vizitat e tyre te votuesit e ngjuar në shtëpi . Do të jetë obligim i vëzhguesve të jenë prezent në kohën dhe vendin e caktuar me qëllim që të shoqërojnë KVVEL-të .

### Neni 3 Procesi i Votimit

3.1 Para nisjes, duke u parë qartë nga KKZ-ja dhe çdo vëzhgues i akredituar i pranishëm, KVVEL-ja:

- a) Mbyll kutinë e fletëvotimeve dhe do të shënojë numrin e shiritit mbyllës të sigurisë në Formularin e përputhjes të VPNRV-së (FPVPNRV), një kopje e të cilit është bashkangjitur si Shtojcë II ;
- b) Merr nga KKZ-ja pakon e lidhur me nga 50 fletëvotime për secilën palë zgjedhje dhe do të shkruajë në FPVPNRV-në përkatëse numrin e gjithmbarshëm të fletëvotimeve të pranuar; dhe
- c) Merr nga KKZ-ja listën e votuesve të ngjuar në shtëpi (LVNSH) e cila do të përfshijë emrin, mbiemrin, numrin personal të dokumentit të vlefshëm identifikues, si dhe adresat e personave të ngjuar në shtëpi të shënuar sipas radhës së vizitave nga KVVEL-ja.

3.2 Te shtëpia e votuesit të ngjuar, KVVEL-ja:

- a) duhet të tregojë distinktivët identifikues të dhënë dhe të vulosur nga KKZ-ja gjatë gjithë kohës sa zgjatë procesi;
- b) Kërkon nga votuesi që të identifikohet duke përdorur një dokument identifikimi të pranueshëm siç parashikohet në nenin 90 të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, mbi Dokumentet e pranueshme të identifikimit;
- c) pas identifikimit të votuesit dhe pasi që të dhënat e votuesit të jenë shënuar në Listën e Votuesve të ngjuar në shtëpi me kusht (LVLSHK), anëtarët e KVVEL-ës duhet shënuar të dhënat e votuesit në zarfet e fletëvotimeve me kusht, pastaj do t'i jepet votuesit fletëvotimi(et) dhe do të udhëzohet votuesi për procedurat e votimit;
- d) ia mundëson votuesit që t'i ndihmojë për të votuar çdo person i pranishëm, por jo anëtari i KVVEL-së e as vëzhguesi i akredituar;
- e) kërkoj nga të gjithë personat e pranishëm, me përjashtim të personit të përcaktuar në nenin 3.2(d) të kësaj Rregulle, që të dalin nga dhoma, për t'ia bërë të mundur votuesit të ngjuar në shtëpi që të shënojë fletëvotimet;
- f) jep votuesit një fletëvotim tjetër nëse ai/ajo e ka dëmtuar fletëvotimin e parë, të mbaj fletëvotimin e dëmtuar dhe ta shënoj si “i dëmtuar”; dhe
- g) siguron që pas shënimit të fletëvotimit(ve) personi i ngjuar në shtëpi të fus fletëvotimin(et) në Zarf(at) e Fshehtësisë, të lidhet Zarf(at) i Fshehtësisë dhe futet Zarf(at) i Fshehtësisë brenda Zarf(at) të Fletëvotimeve me Kusht (ZVK). Pas lidhjes së ZVK, votuesi do ta vendosi atë në kutinë e votimit nën vështrimin e çdonjërit nga vëzhguesit e akredituar të pranishëm.

3.3 Nëse KVVEL-ja arrin të shtëpia e votuesit të ngjuar në shtëpi dhe votuesi refuzon që KVVEL-ja të hyjë në shtëpi, në LVLSHK, para emrit të votuesit të shënohet se “refuzon“, dhe të gjithë anëtarët e KVVEL të nënshkruhen pranë hapësirës “refuzon“. Pastaj KVVEL-ja do të largohet nga shtëpia e Votuesit të Ngjuar në Shtëpi.

3.4 Në fund të procesit të votimit, KVVVEL - do ta mbylli vrimën e kutisë së votimit dhe do ta dërgon materialin te KKZ-së ku, në praninë e KKZ-ve ose të vëzhguesve që janë prezent, KVVVEL bën llogaritjen e fletëvotimeve të pa përdorura dhe dëmtuara dhe e dorëzon materialin te KKZ-së.

#### Neni 4 Votimi në Institucione

4.1 KKZ-të duhet t'i identifikojnë institucionet e përcaktuara sipas nenit 1.2(b) të kësaj rregulle brenda komunës së vet, t'i bëjnë përgatitjet e nevojshme për votim, si dhe të informojnë administratën e institucioneve përkatëse për planin dhe orarin e ekipit për votim në institucione (EVI) në përputhje me numrin e votuesve në secilin institucion. Duke vepruar kështu, EVI-ja e njëjtë mund të vizitojë një ose më shumë institucione gjatë kohës së votimit siç përcaktohet me nenin 1.5 të kësaj rregulle për orarin e punës së EVI, ose KKZ-ja mund të vendosë që të caktojë më shumë se një EVI në të njëjtin institucion nëse nevojat e institucionit të caktuar e kërkojnë këtë.

4.2 Ekipi për votim në institucione (EVI) do të përbëhet nga një kryesues dhe dy anëtarë. KKZ-ja do të vendosë numrin e EVI-ve të nevojshëm për të udhëhequr procesin e votimit në institucione. Kur të jetë përcaktuar numri i EVI-ve, KKZ-ja do t'i plotësojë këto poste nga radhët e anëtarëve rezervë të Këshillave të Vendvotimeve (KVV-ve), siç përshkruhet në nenin siç përshkruhet në neni 79 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Jo më shumë se një person nga një subjekt politik mund të emërohet anëtar i EVI-së në të njëjtin EVI. Nëse bëhet e domosdoshme për të zëvendësuar një anëtar të EVI-së, do të zbatohen procedurat e caktuara me nenin 74.7 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

4.3 EVI-ja punon si ekip lëvizës që shkon nga një votues te tjetri me kutinë lëvizëse të fletëvotimeve, ose do të vendosë një Vendvotim brenda institucionit dhe do t'u mundësojë votuesit që të formojnë një rresht, cilado prej këtyre dy mundësive që t'u shërbejë më së miri interesave të votuesve dhe planit të institucionit.

4.4 EVI-ja zbaton procedurat e njëjta për hedhjen e Fletëvotimeve me Kusht siç përcaktohet me nenin 12 të Rregullës Zgjedhjet të KQZ-ës nr 09/20009, Për Votimin dhe Numërimin Brenda VV

4.5 Për të votuar në njërin nga institucionet e përcaktuara sipas nenin 1.2 (b) të kësaj Rregulle, votuesi me zotësi juridike duhet të jetë i regjistruar në institucionet e lartpërmendura më së voni në Ditën e Zgjedhjeve.

4.6 Votuesi me zotësi juridike mund të hedhë fletëvotimin me kusht në institucionin në të cilin ai është i vendosur nëse në kohën e vizitës nga EVI-ja ai/ajo mund të identifikohet me një dokument të identifikimit të pranueshëm siç përcaktohet me nenin 90 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, mbi Dokumentet e pranueshme të identifikimit

4.7 Në fund të procesit të VPNRV-së, EVI-ja duhet të mbyllë vrimën e kutisë së votimit dhe t'i dërgojë të gjitha materialet në KKZ, ku nën vështrimin e KKZ-së ose të vëzhguesve të pranishëm, EVI-ja do t'i numërojë llogaritjen e fletëvotimeve të papërdorura dhe të dëmtuara dhe t'ia dorëzojë materialin KKZ-së.

#### Neni 5 Votimi në Rrethana të Veçanta

5.1 KKZ-të do të përgatisin paraprakisht listën me lokacionet ku ndodhen/jetojnë votuesit në rrethana të veçanta

5.2 Në bazë të nenit 99.1, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, për numrin e votuesve dhe personat e caktuar që do të shfrytëzojnë këtë të drejtë, do të vendos KKZ-ja.

5.3 KKZ-ja do t'i informojë paraprakisht votuesit përkitazi me kohën dhe vendin e saktë ku do të mbahet votimi në rrethana të veçanta (VRrV)- për të zhvendosurit.

5.4 Ekipi për votim në rrethana të veçanta (EVRrV) do të përbëhet nga një kryesues dhe dy anëtarë. KKZ-ja do të vendosë numrin e EVRrV-së të nevojshëm për të udhëhequr procesin e votimit me nevoja të veçanta. Kur të jetë përcaktuar numri i EVRrV-ve, KKZ-ja do t'i plotësojë këto poste nga radhët e anëtarëve rezervë të Këshillave të Vendvotimeve (KVV-ve), siç përshkruhet në nenin 79 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Jo më shumë se një person nga një subjekt politik mund të emërohet anëtar i EVRrV-së në të njëjtin EVRrV. Nëse bëhet e domosdoshme për të zëvendësuar një anëtar të EVRrV-së, do të zbatohen procedurat e caktuara me nenin 74.7 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës

5.5 Votimi dhe numërimi për votimin në rrethana të veçanta do të bëhen në të njëjtën mënyrë si Votimi me Votë me Kusht, siç është e përcaktuar me nenin 12 të Rregullës Zgjedhore nr. 09/2009. për Votim dhe Numërim brenda Vendvotimit

5.6 Pasi të përfundojë votimi në rrethana të veçanta, EVRrV-ja e mbyllë vrimën e kutisë së votimit dhe i dërgon të gjitha materialet në KKZ, ku nën vështrimin e KKZ-së ose të vëzhguesve të pranishëm, EVRrV-ja do të bëjë llogaritjen e fletëvotimeve të papërdorura dhe të dëmtuara dhe ia dorëzon materialin KKZ-së.

5.7 Si alternativë mund të parashohim votim të hershëm para ditës së zgjedhjeve dhe përmes postës, pasi të jenë identifikuar të gjithë votuesit e interesuar për votim me nevoja dhe rrethana të veçanta

## Neni 6 Procesi i Gjykimit

6.1 KKZ-ja duhet të njoftoj me shkrim çdo votues me zotësi juridike ose grupit të votuesve të cilëve u është mohuar kërkesa për VPNRV, duke i informuar për të drejtën e tij për të kërkuar korrigjim ligjorë te organet kompetente në pajtueshmëri me Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

6.2 Nëse organi kompetent brenda autoriteti të vet vendos se Votuesi ka të drejtë të marrë pjesë në programin e VPNRV mund ta urdhëroj KKZ-në ta inkuadroj ose largoj votuesin nga lista e VPNRV.

Neni 7  
Hyrja në fuqi

Kjo Rregull zgjedhore hyn në fuqi më 25.06.2009.

**Nesrin Lushta**

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve



---